



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:216816
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05801323
P.nr.2023:216816

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit K.A për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi apo heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.5 lidhur me par.3 dhe par.2 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP.nr.974/22 të dt.22.11.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt.05.06.2024, ku prezent ishin Prokuroria e shtetit Uridia Caka, i akuzuari K.A me mbrojtësin e tij av.R.A me autorizim, me dt.07.06.2024, shpallë, ndërsa me dt.10.06.2024, e përpilon këtë:

AKTGJYKIM

I AKUZUARI: K.A, nga i ati Y dhe e ëma Xh e lindjes B, i lindur më datën në Gjakovë, banon në fshatin Pataqan i Poshtëm komuna Rahovec, me nr.personal:...., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i ati i 5 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se me datë 29.05.2022 rreth orës 11:00 në Rahovec, i pandehuri K.A në cilësinë e pronarit të kompanisë „A” duke qenë përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës (neni 6 i ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë), nuk i siguron masat për parandalimin e rreziqeve profesionale dhe masat për organizimin e mbarëvajtjes së procesit të punës gjegjësisht anësoret e kryqëzuara në skele dhe në mungesë të tyre i dëmtuari L.A pëson lëndime të rënda trupore, në atë mënyrë që gjersa i dëmtuari ishte mbi skele në katin e dytë të shtëpisë e cila ishte në ndërtim (fasadim) e sipër, për një moment rrëzohet nga një lartësi rreth 2 metra dhe bie tokë, me ç’rast i dëmtuari pëson lëndime të rënda trupore dhe atë gërvishje në mollëzen e majtë dhe gjakmbledhje nënlekturore në regjionin temthor të majtë të kokës, grumbullim minimal ajri në zgavren e majtë të krahorit, trauma e shumëfishtë, ndrydhje e mushkërive të shkaktuara nga perplasja e trupit me sipërfaqe të forte, të përshkruara si në akt ekspertimin mjeko-ligjor të dr.F.B, datë 17.07.2023.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale Asgjësimi, dëmtimi apo heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.5 lidhur me par.3 dhe 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 17, 39, 40, 42, 43, 44, 46, 69, e nenit 358 par.5 lidhur me par.3 dhe 2 të KPRK-së si dhe nenit 364, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtin e :

G J Y K O N

Me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, me kërkesën dhe pëlqimin e mbrojtësit të të akuzuarit, av.R.A dhe të akuzuarit K.A dënimi me burgim i zëvendësohet me dënimin me gjobë.

Në bazë të nenit 44 par.2 të KPRK-së, gjykata të njëjtit ia shqipton :

DËNIMIN ME GJOBË në shume prej **dymijë euro (2000 €)**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Poqe së dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqind ditësh (100), duke llogaritur çdo ditë burgu me nga 20 €.

Obligohet i akuzuarit në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumen prej tridhjetë euro (30 €), për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej njëzet euro (20 €), ndërsa në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumë prej pesëdhjetë euro (50), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të bëhet me detyrim.

I dëmtuari L.A lidhur me kërkesën pasuare juridike udhëzohet në kontestin civil.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1892/2022 të dt. 26.04.2024, e ka akuzuar K.A, për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi apo heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.5 lidhur me par.3 dhe par.2 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.05.06.2024, ku prezent kanë qenë, prokuroria e shtetit Uridia Caka, i akuzuari K.A me mbrojtësin e tij av.R.B ndërsa nuk ka prezantuar i dëmtuari pasi që i njëjti ka qenë jashtë vendit, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari K.A, pas konsultimit paraprak me mbrojtësin e tij deklarohet i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se më vije keq për rastin i cili ka ndodhur, të dëmtuarin e kam djalë të vëllait, kemi raporte të mira pasi që jetojmë me një bashkësi familjare.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.R.A ka deklaruar: Pas konsultimit paraprak me të mbrojturin tim meqenëse ju shpjegua efekti dhe benefiti i pranimit të fajësisë i njëjti në mënyrë vullnetare ka pranuar fajësinë, andaj kërkojmë nga gjykata që të aprovohet pranimi i fajësisë, po ashtu kërkojmë nga gjykata që me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit të merre parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, hera e pare që ka rënë nën dëshirë me ligjin, pendimin, veprën penale e ka kryer pa dashje pasi që edhe të dëmtuarin e ka familjar respektivisht e ka djalë të vëllait, andaj kërkojmë nga gjykata që të ketë parasysh gjitha rrethanat lehtësuese po ashtu i propozojmë gjykatës dhe japim pëlqim se në rast eventual të shqiptimit të dënimit me burg të zëvendësohet dënimi me dënim me gjobë, po ashtu gjykata të ketë parasysh edhe rrethanat materiale të të mbrojturit tim.

I akuzuari K.A pajtohet dhe jep pëlqimin ashtu siç propozojë mbrojtësi i tij që në rast të shqiptimit të dënimit me burg të zëvendësohet me dënim me gjobë.

Prokurorja e shtetit Uridia Caka në shqyrtimin fillestar ka deklaruar: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari meqenëse i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes, provat materiale dhe personale në bazë të cilave është ngritur kjo aktakuzë andaj i propozojë gjykatës që ta miratojë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit, po ashtu të ketë parasysh me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për këtë të akuzuar.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-se i akuzuari K.A nga pakujdesia ka kryer veprën penale Asgjësimi, dëmtimi apo heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.5 lidhur me par.3 dhe par.2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtyre faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Raporti i oficerit S.H, datë 29.05.2022;
- Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njesia e Forenzikës, datë 13.06.2022;
- Raporti zyrtar i përpiluar nga Inspektorati i Punës me numër 527/22 datë 03.06.2022;
- Akt ekspertimi mjeko-ligjor i punuar nga dr.F.B, datë 17.07.2023;
- Raporti mjekësor me numër 7248 datë 29.05.2022 i lëshuar nga Reparti i emergjencës - Spitali Rajonal në Gjakovë dhe Fletëlëshimi i lëshuar nga QKUK në Prishtinë, datë 01.06.2022;
- Deklarata e të dëmtuarit L.A, e dhënë në polici me dt.07.06.2022;
- Deklarata e të pandehurit K.A, e dhënë në polici me dt.29.05.2022 dhe në prokurori me dt.27.10.2023;
- Fotografitë dhe shkresat tjera në lëndë.

4. Elementet e veprës penale.

Në nenin 358 par.5 lidhur me par.3 dhe 2 të KPRK-së, është parashikuar se: *Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të një apo më shumë personave ose me dëm substancial material, kryesi dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet lidhur me Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet dhe Kushdo që është përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës dhe i cili nuk i instalon pajisjet mbrojtëse, nuk i mirëmban ato në gjendje të rregullt për punë, nuk siguron përdorimin e tyre kur është e nevojshme apo nuk vepron në pajtim me dispozitat apo rregullat teknike mbi masat për sigurinë në vendin e punës dhe me këtë rrezikon jetën e njerëzve ose shkakton dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

5 Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin K.A e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale Asgjësimi, dëmtimi apo heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.5 lidhur me par.3 dhe par.2 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit.

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, ashtu që gjykata me rastin e caktimit të dënimit pati parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, i gjendjes së mesme ekonomike, mbajtës i familjes prej 7 anëtarësh, ka një biznes të vogël i cili

merret me punë të ndërtimtarisë dhe atë me punë sezonale, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej kurrfarë vepre penale , të dëmtuarin e ka familjar(djal të vëllait), ndërsa si rrethanë renduese gjykata mori rrezikshmërinë e veprës penale, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me gjobë në shume prej **dymijë euro (2000 €)**, mund të arrihen qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi udhëzimin në kontestin civil

Vendimi mbi udhëzimin në kontestin civil është marr konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.2023:216816, me dt.07.06.2024.

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.